



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.82/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Kunushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me apelin e Gent Mirdita nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 23.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pas afatshme apeli i identifikuar Anr.82/2019, i paraqitur nga Gent Mirdita, me të cilin ka kërkuar që t përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 23.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Gent Mirdita, në të cilin paraqitsi i apelit, pretendon se ka plotësuar formularin për të votuar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpro sipas tij nuk i është publikuar emri në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës. Paraqitësi i apelit, i ka bashkangjitur apelit, formularin për aplikim si votues jashtë Kosovës, andaj ka kërkuar nga PZAP-i, që t'i mundësohet e drejta në përfshirjen e listës së votuesve.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pas afatshëm

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i paraqitur nga Gent Mirdita kundër vendimit të KQZ-së, është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 122 paragraf 1 të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.09.2019 dhe ka përfunduar me datën 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër), orë

nga marrja e vendimit. Apeli në PZAP, nga paraqitësi i apelit, është paraqitur me datë 23.09.2019, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 82/2019 me datën 23.09.2019

Kryesues i Panelit

Bejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.